

VENDIM  
I  
GJYQTARIT TË VETËM

Sot, më datë 05.09 2007, unë [Signature], gjyqtare pranë kësaj gjykate, pasi studjova kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur nga Av. Jola Gjuzi përfaqësuese e autorizuar e Shoqërisë "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHA, për depozitimin e akteve të personit juridik,

KONSTATOVA SE:

Shoqëria "ELDA PETROLEUM ALBANIA" SHPK është person juridik i së drejtës shqiptare e regjistruar në Regjistrin tregtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 22438, datë 15 Dhjetor 1999, me ortak të vetëm shoqërinë "Global Petroleum Albania" SHA., person juridik i së drejtës shqiptare, regjistruar në Regjistrin tregtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 21689, datë 20 Korrik 1999.

Më datë 27 Nëntor 2006, Asambleja e Jashtëzakonshme e Shoqërisë "Global Petroleum Albania" SHA, kjo e fundit si Ortaku i Vetëm i Shoqërisë "Elda Petroleum Albania" SHPK, u mbledh në selinë e saj, me të pranishëm aksionerët **Hellenic Petroleum S.A** e përfaqësuar ligjërisht nga Z. Gerasimos Stanitsas, sipas Autorizimit datë 21.11.2006 të Z. Panos Cavoulacos, Drejtor Ekzekutiv i Shoqërisë "HELLENIC PETROLEUM" S.A. sipas Vendimit nr. 1071, datë 27.04.2006 të Bordit të Drejtorëve dhe **Dimitris Gaavril**. Aksionerët e tjerë Apostol Goci, Friden Kuqi dhe Besnik Sula nuk ishin të pranishëm në mbledhje edhe pse të njoftuar rregullisht sipas njoftimeve të marra në datën 10.11.2006.

Asambleja e Jashtëzakonshme ka verifikuar praninë e ortakëve të "Global Petroleum Albania" SHA dhe është siguruar se ishin të pranishëm në mbledhje, personalisht, zotëruesit e 1.772.855 aksioneve me vlerë nominale 1,000 LEK secili, që përfaqësojnë në të njëjtën kohë 99,971 për qind të kapitalit, përkatësisht:

- 1) "HELLENIC PETROLEUM" S.A., që zotëron 1,556,855 aksione të cilat i korrespondojnë 99.957 për qind të kapitalit aksioner;
- 2) Z. Dimitris GAVRIIL që zotëron 216 aksione të cilat i korrespondojnë 0.014 për qind të kapitalit aksioner.

Në këto kushte u pranua që Asambleja është e mbledhur rregullisht dhe duke patur shumicën e kërkuar, mund të marrë vendime të cilat do të jenë të lidhura me shoqërinë "Global Petroleum Albania" SHA si dhe me shoqërinë "Elda Petroleum Albania" SHPK, shoqëri në të cilën "Global Petroleum Albania" SHA zotëron 100% të kuotave.

Kështu, në lidhje me shoqërinë "Elda Petroleum Albania" SHPK, Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve vendosi si vijon:

1. Të miratojë raportin e datës 17 Tetor 2006, të Z. Berti Pashko, ekspert kontabël i autorizuar sipas licencës nr. 7, datë 10.02.2000, për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Elda Petroleum Albania" SHPK, sipas Vendimit të Asamblesë së Shoqërisë datë 4 Maj 2006, depozituar në Regjistrin tregtar me Vendimin e Gjykatës së Tiranës nr. 22438/8, datë 25 Shtator 2006;

2. Në vijim të miratojë përfundimisht zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Elda Petroleum Albania" SHPK në shumën **617,472,990 LEK**, secila kuotë me vlerën 6,174,729,90 LEK dhe të pasqyrojë këtë ndryshim të kapitalit në Statutin e shoqërisë;
3. Të përdorë fitimin e vitit 2005 të shoqërisë "Elda Petroleum Albania" SHPK në shumën 4,814,253 LEK për mbulimin e humbjeve të viteve të kaluara.

Vendimet e tjera të marra nga Asambleja e Jashtëzakonshme e Aksionerëve kishin të bënin me çështje të shoqërisë Global Petroleum Albania SHA.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Pas shqyrtimit të kërkesës, e çmoj atë të mbështetur në ligjin Nr. 7638, 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjin Nr. 7667, datë 28.01.1993 "Për regjistrin tregtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregtare", dhe

### **VENDOSA:**

1. Pranimin e kërkesës;
3. Depozitimin në Regjistrin tregtar të Vendimit të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Shoqërisë "Global Petroleum Albania" SHA datë 27 Nëntor 2006 si ortak i vetëm i Shoqërisë "Elda Petroleum Albania" SHPK, për:
  - a. Miratimin e raportit të datës 17 Tetor 2006, të Z. Berti Pashko, ekspert kontabël i autorizuar sipas licencës nr. 7, datë 10.02.2000, për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Elda Petroleum Albania" SHPK, sipas Vendimit të Asamblesë së Shoqërisë datë 4 Maj 2006, depozituar në Regjistrin tregtar me Vendimin e Gjykatës së Tiranës nr. 22438/8, datë 25 Shtator 2006;
  - b. Në vijim miratimin përfundimisht të zmadhimit të kapitalit të shoqërisë "Elda Petroleum Albania" SHPK në shumën **617,472,990 LEK**, secila kuotë me vlerën 6,174,729,90 LEK dhe të pasqyrojë këtë ndryshim të kapitalit në Statutin e shoqërisë;
  - c. Përdorimin e fitimit të vitit 2005 të shoqërisë "Elda Petroleum Albania" SHPK në shumën 4,814,253 LEK për mbulimin e humbjeve të viteve të kaluara.
3. Depozitimin e akteve shoqëruese:
  - a. Autorizimi i Z. Gerasimos Stanitsas si përfaqësues i aksionarit Hellenic Petroleum S.A., datë 21.11.2006;
  - b. Njoftimet e aksionerëve që nuk ishin të pranishëm në mbledhje marrë në datë 10.11.2006
  - c. Raporti i ekspertit kontabël datë 17 Tetor 2006;
  - c. Autorizimi i lëshuar nga Z. Nikolaos Karachalios dhe Z. Panagiotis Filoxenidis në cilësinë e administratorëve të shoqërisë për Zyrën e avokatisë Kalo & Associates, datë 6 Mars 2007.
4. Pasqyrimin e ndryshimeve në skedën përkatëse të Regjistrin Tregtar.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

**GJYQTARE**

